



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-të për Thirrje publike me Nr.05-453/01-31961 i datës 13.07.2026 "Për ofrimin e mbështetjeje financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve "Rinia Fest Lipjan 2026" në Komunën e Lipjanit, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ "LIPJAN YOUTH CENTER LYC"

#### Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 3,000.00 € (tremijë euro), për t'a mbështetur financiarisht OJQ-në "Lipjan Youth Center LYC", e cila ka aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-31961 të datës 13.07.2026 "Për ofrimin e mbështetjeje financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve "Rinia Fest Lipjan 2026.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja e cila do të mbështetet financiarisht nga Komuna.

| Nr. | Emërtimi i OJQ-së       | Shuma      |
|-----|-------------------------|------------|
| 1.  | LIPJAN YOUTH CENTER LYC | 3,000.00 € |
|     | Shuma Totale            | 3,000.00 € |

#### Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

#### Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

#### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 453/01-38917  
Lipjan, më 11.08.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjetve financiare për fermerë për subvencionimin e qumështit Nr. 15-400/01-29363 të datës 30.06.2026 si dhe Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave Nr.01-320/01-41792 të datës 20.08.2026, Kryetari i Komunës nxjerr:

#### VENDIM

#### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR SUBVENCIONIMIN E QUMËSHTIT

##### Neni 1

Me këtë Vendim, NDAHET, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 45,850.08 ( katërdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë euro e tetë cent) për subvencionimin e qumështit për 57 (pesëdhjetë e shtatë) fermerë të Komunës së Lipjanit me 0.04 cent për litër të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike të shpallur nga Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari me Nr.12-320/01-18568 të datës 22.04.2026 dhe që janë renditur sipas tabelës në vijim:

| Nr | Emri dhe mbiemri | Fshati              | Komuna | Sasia e qumështit të dorëzuar/L | Çmimi | Totali në euro € |
|----|------------------|---------------------|--------|---------------------------------|-------|------------------|
| 1  | Donisa Mehmeti   | Babush I Muhaxherve | Lipjan | 18010                           | 0.04  | 720.40           |
| 2  | Arben Rudari     | Rubovc              | Lipjan | 22456                           | 0.04  | 898.24           |
| 3  | Njazi Hajdini    | Rufc                | Lipjan | 23849                           | 0.04  | 953.96           |
| 4  | Nestret Hajdini  | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 14630                           | 0.04  | 585.20           |
| 5  | Enver Hajdini    | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 21429                           | 0.04  | 857.16           |
| 6  | Xhevdet Shala    | Shale               | Lipjan | 14683                           | 0.04  | 587.32           |
| 7  | Alban Hajdini    | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 26927                           | 0.04  | 1077.08          |
| 8  | Bleron Rama      | Ribar I madh        | Lipjan | 6195                            | 0.04  | 247.80           |
| 9  | Edmond Hoxha     | Shale               | Lipjan | 12743                           | 0.04  | 509.72           |

|    |                   |                     |        |        |      |         |
|----|-------------------|---------------------|--------|--------|------|---------|
| 10 | Bajram Shala      | Kleqke              | Lipjan | 5772   | 0.04 | 230.88  |
| 11 | Ibush Qamili      | Babush I Muhaxherve | Lipjan | 23552  | 0.04 | 942.08  |
| 12 | Rexhep Shillova   | Topliqan            | Lipjan | 14978  | 0.04 | 599.12  |
| 13 | Shaban Musliu     | Kojske              | Lipjan | 14551  | 0.04 | 582.04  |
| 14 | Murat Emini       | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 8126   | 0.04 | 325.04  |
| 15 | Arbër Haziri      | Banulle             | Lipjan | 23353  | 0.04 | 934.12  |
| 16 | Hasan Pasjaqa     | Gllanice            | Lipjan | 10538  | 0.04 | 421.52  |
| 17 | Lirije Avdullahu  | Gumnaselle          | Lipjan | 27208  | 0.04 | 1088.32 |
| 18 | Qemajl Rudari     | Rubovc              | Lipjan | 17670  | 0.04 | 706.80  |
| 19 | Mehmet Selmani    | Babush I Muhaxherve | Lipjan | 37400  | 0.04 | 1496.00 |
| 20 | Zejnullah Pasjaqa | Gllanice            | Lipjan | 11836  | 0.04 | 473.44  |
| 21 | Sabit Duriqi      | Ribar I Madh        | Lipjan | 29986  | 0.04 | 1199.44 |
| 22 | Hajdin Mustafa    | Janjeve             | Lipjan | 8647   | 0.04 | 345.88  |
| 23 | Mustafe Rudari    | Rubovc              | Lipjan | 26146  | 0.04 | 1045.84 |
| 24 | Rinor Murati      | Kojske              | Lipjan | 31294  | 0.04 | 1251.76 |
| 25 | Bajram Rudari     | Rubovc              | Lipjan | 25253  | 0.04 | 1010.12 |
| 26 | Hajrullah Pasjaqa | Gllanice            | Lipjan | 15203  | 0.04 | 608.12  |
| 27 | Ymer Dugolli      | Vrelle e Goleshit   | Lipjan | 9173   | 0.04 | 366.92  |
| 28 | Qeshka Gashi      | Brus                | Lipjan | 5857   | 0.04 | 234.28  |
| 29 | Zyrafete Qadraku  | Vershec             | Lipjan | 12398  | 0.04 | 495.92  |
| 30 | Sherif Gashi      | Lluge               | Lipjan | 23583  | 0.04 | 943.32  |
| 31 | Ibush Hajrizi     | Gumnaselle          | Lipjan | 25398  | 0.04 | 1015.92 |
| 32 | Milazim Haziri    | Banulle             | Lipjan | 19153  | 0.04 | 766.12  |
| 33 | Besnik Jashari    | Dobraje e Vogel     | Lipjan | 12989  | 0.04 | 519.56  |
| 34 | Irfan Bytyqi      | Topliqan            | Lipjan | 26432  | 0.04 | 1057.28 |
| 35 | Hashim Ahmeti     | Torine              | Lipjan | 6230   | 0.04 | 249.20  |
| 36 | Rifat Rudari      | Rubovc              | Lipjan | 13605  | 0.04 | 544.20  |
| 37 | Xhelil Ajvazi     | Dobraje e Madhe     | Lipjan | 103772 | 0.04 | 4150.88 |
| 38 | Xhevdet Jakupi    | Bregu I Zi          | Lipjan | 13284  | 0.04 | 531.36  |
| 39 | Hamdi Gashi       | Sllovi              | Lipjan | 27239  | 0.04 | 1089.56 |
| 40 | Skender Hajdini   | Rufc I vjeter       | Lipjan | 22954  | 0.04 | 918.16  |
| 41 | Armend Luma       | Kraishte            | Lipjan | 4151   | 0.04 | 166.04  |
| 42 | Rrahim Morina     | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 4363   | 0.04 | 174.52  |
| 43 | Imri Seferi       | Rufc I Vjeter       | Lipjan | 3330   | 0.04 | 133.20  |
| 44 | Jetmir Musliu     | Kojskë              | Lipjan | 19914  | 0.04 | 796.56  |
| 45 | Dardan Kadriu     | Hallaq i Vogël      | Lipjan | 7570   | 0.04 | 302.80  |
| 46 | Veton Bahtiri     | Dobrajë e Madhe     | Lipjan | 18547  | 0.04 | 741.88  |
| 47 | Behlul Aliu       | Kojskë              | Lipjan | 29375  | 0.04 | 1175.00 |
| 48 | Sali Fejzullahi   | Gadime Epërme       | Lipjan | 11397  | 0.04 | 455.88  |
| 49 | Alban Zymeri      | Llugaxhi            | Lipjan | 18035  | 0.04 | 721.40  |
| 50 | Gafurr Limani     | Gadime Epërme       | Lipjan | 25273  | 0.04 | 1010.92 |
| 51 | Isuf Demiri       | Gadime Epërme       | Lipjan | 11413  | 0.04 | 456.52  |
| 52 | Enis Limoni       | Lipjan              | Lipjan | 38894  | 0.04 | 1555.76 |
| 53 | Laureta Zejna     | Topliqan            | Lipjan | 28389  | 0.04 | 1135.56 |
| 54 | Shyreta Grajçevci | Ribar i Madh        | Lipjan | 54868  | 0.04 | 2194.72 |

|    |                   |               |        |                |      |                 |
|----|-------------------|---------------|--------|----------------|------|-----------------|
| 55 | Florim Bajraktari | Baicë         | Lipjan | 15330          | 0.04 | 613.20          |
| 56 | Zyrifa Halili     | Ribar i Madh  | Lipjan | 32248          | 0.04 | 1289.92         |
| 57 | Bahrije Hajdari   | Rufc i Vjetër | Lipjan | 8653           | 0.04 | 346.12          |
|    | <b>Totali</b>     |               |        | <b>1146252</b> |      | <b>45850.08</b> |

#### Neni 2

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe përfituesve do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjet të cilat do të lidhen në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit fermer veq e veq.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

1Nr. 320/01-41792/2

Lipjan, më 20.08.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

### **VENDIM**

### **PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

#### **Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,000.00€**, (shtatë mijë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-36816 e datës 03.08.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 25 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin korrik të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast  $25 \times 280 = 7,000.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### **Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

#### **Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-36816  
Lipjan, më 04.08.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1  
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve të klubeve sportive në fushën e sportit për kategorinë e seniorëve për vitin 2026, Nr.05-453/01-34248 të datës 23.07.2026, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Arta Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Vjosa Gashi nga OJQ-të anëtare
5. Florim Budakova, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar
6. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezervë

Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve të klubeve sportive në fushën e sportit për kategorinë e seniorëve për vitin 2026, Nr.05-453/01-34248 të datës 23.07.2026 ,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3  
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-40261  
Lipjan, më 14.08.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

### VENDIM

### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË FERMERËVE

#### Neni 1

#### Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të fermerëve për ndarjen e subvencioneve të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike për aplikim për vitin përkatës, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Sektori për çështje pronësoro- juridike, Kryesues
2. Valdete Muji , Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Behar Aliu, Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve, anëtar

#### Neni 2

#### Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

- Bën shqyrtimin e ankesave të fermerëve për ndarje të subvencioneve të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim gjatë vitit përkatës brenda afatit prej 10 ditësh pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 dhe kriterëve të përcaktuara në shpalljen publike dhe legjislacionin në fuqi.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Vendimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Mandati i komisionit është tre vjeçar.

#### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit si dhe Drejtorati për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural .

INr. 020/04-44378  
Lipjan, më 27.08.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-40477 e datës 14.08.2026, Kryetari i Komunës merr:

### **VENDIM**

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË FERMERËVE**

#### **Neni 1**

#### **Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve, konform Shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-40477 e datës 14.08.2026 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për ndarjen e Serrave në sipërfaqe prej 50m<sup>2</sup> për vitin 2026, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesuese
2. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare

#### **Neni 2**

#### **Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit, janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për sera për vitin 2026 të cilët kanë aplikuar sipas Shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-40477 e datës 14.08.2026 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimi të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe kriteret e Shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-40477 e datës 14.08.2026.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-44384  
Lipjan, 27.08.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 , Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, **Lorik Berbatovci**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës të OJQ-së përfituese të subvencioneve sipas Thirrjes Publike për mbështetje Financiare për Aktivitete të Organizatave Joqeveritare në fushen e Rinis "Nr.05-453/01-31961 të datës 13.07.2026 , të shpallur nga Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja- e cila duhet të monitorohet nga zyrtari përgjegjës i cekur më lartë .

| Nr. | Emërtimi i OJQ-së)      |
|-----|-------------------------|
| 1.  | LIPJAN YOUTH CENTER LYC |

**Neni 2**

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës të OJQ-së përfituese të subvencioneve , konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës **Lorik Berbatovci** dhe Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-39205

Lipjan, më 11.08.2026

KRYETARI I KOMUNËS  
**Imri Ahmeti**